

BULETIN INFORMATIV



Zhvillimet në fushën e politikave dhe legjislacionit që garantojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara ● Prill 2020 - Qershor 2020



Përmbajtja

- 1** Vendim, nr. 251, datë 27.3.2020 "Për një ndryshim në vendimin nr. 269, datë 29.3.2017, të këshillit të ministrave, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", të ndryshuar".
- 2** Urdhër, nr. 220, datë 1.4.2020 "Për një ndryshim në urdhrin nr. 158, datë 11.3.2020, "Për pezullimin e funksionimit të komisioneve të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara dhe invaliditetit të punës".
- 3** Ligj nr. 35/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi penal i republikës së shqipërisë", të ndryshuar".
- 4** Udhëzim nr. 253, datë 10.4.2020 "Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, për arsye të epidemisë së shkaktuar nga covid-19".
- 5** Urdhër nr. 367, datë 9.6.2020 "Për miratimin e udhëzuesit "Kriteret e përgjithshme të pjesëmarrjes në aktivitetet, proceset konsultuese dhe vendimmarrëse, që lidhen me fëmijët dhe për fëmijët".
- 6** Vendim nr. 301, datë 15.4.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët".
- 7** Vendim nr. 353, datë 29.4.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 327, datë 28.5.2014, të këshillit të ministrave, "Për përcaktimin e formatit dhe mënyrës së mbledhjes e të raportimit të të dhënave nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, publik ose privat".
- 8** Vendim nr. 371, datë 6.5.2020 "Për dhënie shpërblimi për personelin që shërben në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike, që janë në përgjegjësi administrimi të shërbimit social shtetëror dhe të bashkive".
- 9** Urdhër nr. 254, datë 10.4.2020 "Për protokollin e funksionimit të qendrave rezidenciale publike dhe jopublike, që ofrojnë shërbimin e strehimit (strehëzat) për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, në situatën e pandemisë së covid-19".
- 10** Vendim nr. 348, datë 29.4.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit".

VENDIM - Nr. 251, datë 27.3.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 269,
DATË 29.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE
QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM
TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM
TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM
TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEN
NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të neneve 2 e 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të neneve 1 e 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit të punës”, të ndryshuar, ... të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën

sociale në Republikën e Shqipërisë”, është aprovuar ky vendim i cili parashikon si grup që përfiton nga përjashtimi i tarifave vjetore të shkollimit, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, edhe studentët, të cilët kanë, të paktën, njërin prind person me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.

Lexoni të plotë në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/03/27/251/e2b50fe1-c292-427d-ab6b-54f82b8cf649>

URDHËR - Nr. 220, datë 1.4.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 158,
DATË 11.3.2020, “PËR PEZULLIMIN E FUNKSIONIMIT
TË KOMISIONEVE TË VLERËSIMIT TË PERSONAVE
ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE INVALIDITETIT TË PUNËS”**

Në mbështetje të nenit 116, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 10107 datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 7 të ligjit nr. 57/2019 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, si edhe udhëzimit të Institutit të

Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, MSHMS nxori këtë urdhër, i cili shtyn afatin “Për pezullimin e funksionimit të komisioneve të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar dhe invaliditetit të punës”, deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019”.

Lexoni të plotë në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/04/01/220/19417a7c-a917-4bb9-afd8-06d613592715>

LIGJ - Nr. 35/2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, janë bërë disa shtesa dhe ndryshime në lidhje me dhunën në familje. Më konkretisht është ndryshuar Neni 130/a, në lidhje me masën e dënimit në rastet kur ushtrohet dhunë në familje, përfshirë (a) Dënimin me burgim deri në tre vjet në raste të rrahjes, si dhe çdo veprë tjetër dhune fizike, psikologjike, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij; (b) dënimin me burgim deri në katër vjet në raste të kanosjes serioze për vrasje ose plagosje të rëndë; (c) dënim me burgim deri në pesë vjet në raste të plagosjes së kryer me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë.

Po kështu kjo VKM parashikon se moszbatimi ose kryerja e veprimeve në kundërshtim me aktet ligjore apo nënligjore të nxjerra nga organet shtetërore, në funksion të gjendjes së epidemisë apo të zbatimit të masave të jashtëzakonshme, nga personi, ndaj të cilit është dhënë më parë masë administrative, përbën kundrvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë

muaj. Kur kjo veprë, kur është kryer në ushtrim të aktivitetit tregtar, duke vendosur në rrezik shëndetin e njerëzve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Moszbatimi i urdhrat të dhënë nga organet kompetente për karantinim ose izolimin, apo shkelja e rregullave të karantinës ose të izolimit nga personi mbartës ose jo i sëmundjes infektive, të cilit i është njoftuar ky detyrim nga autoritetet shtetërore përkatëse, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet.

Përhapja me dashje e sëmundjes infektive me rrezikshmëri të lartë për shëndetin, nëpërmjet kryerjes së veprimeve ose mosveprimeve nga personi që është diagnostikuar si mbartës i sëmundjes apo nga personi që ka qëllim përhapjen e saj, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kur kjo veprë është kryer nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Po kjo veprë, kur ka shkaktuar pasojë të rënda për shëndetin ose rrezik për jetën e njerëzve, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Lexoni të plotë në: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/04/16/35/8dabf5aa-6226-4ced-b9d0-76b88493da7b>

UDHËZIM - Nr. 253, datë 10.4.2020

PËR MENAXHIMIN E RASTEVE TË FËMIJËVE NË NEVOJË PËR MBROJTJE GJATË PERIUdhËS SË FATKEQËSISË NATYRORE, PËR ARSYE TË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 2, të nenit 42 dhe të nenit 53, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; të nenit 24, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbime të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; të germës “a”, të pikës 6.1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”; të nenit 5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, MSHMS nxjerr këtë udhëzim për Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Shërbimin Social

Shtetëror, Institutin e Shëndetit Publik, strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, i cili përcakton procedurat dhe veprimet konkrete të strukturave të mbrojtjes së fëmijës, për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Udhëzimi, përcakton se strukturat e mbrojtjes së fëmijëve tregojnë vëmendje të veçantë për trajtimin, sipas procedurave të përcaktuara, të rasteve të fëmijëve në nevojë. ç) të izoluar në shtëpi që nuk kanë akses në shërbime, si fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët me sëmundje kronike;

Ky udhëzim, gjithashtu përcakton se fëmijët më aftësi të kufizuara, ndaj të cilëve merret masa emergjente e mbrojtjes ose masa e mbrojtjes për vendosjen e tyre në përkujdesje alternative, do të ▶▶▶

• vendosen në institucione të përkujdesjes shoqërore për këto grupe përfutuesish, duke i ofruar shërbim psikosocial dhe shërbim të specializuar, duke respektuar procedurat e përcaktuara në pikën 3 dhe 6 të këtij udhëzimi (Kreu III), në lidhje me masat mbrojtëse. (3. Fëmija qëndron në izolim, nën përkujdesje gjatë gjithë kohës që ai/ajo është e infektuar nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19. 6. Institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale marrin të gjitha masat për përcaktimin e një hapësire të posaçme për karantinimin e fëmijëve që janë brenda institucionit

dhe shfaqin shenjat e COVID-19, por edhe për fëmijët të cilët vendosen në institucion me masë mbrojtje, deri në momentin e daljes së rezultateve pas testimit të tyre. Gjatë periudhës së karantinës fëmija mbikëqyret nga personeli shëndetësor dhe nga një punonjës social, të cilët janë të pranishëm gjatë gjithë kohës, për të mbështetur fëmijën dhe për të parandaluar përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.)

Lexoni të plotë në: <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2020/04/10/253/b729b35e-8f61-4bd9-be9f-089ac3797fe4>

URDHËR - Nr. 367, datë 9.6.2020

PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PJESËMARRJES NË AKTIVITETET, PROCESET KONSULTUESE DHE VENDIMMARRËSE, QË LIDHEN ME FËMIJËT DHE PËR FËMIJËT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 372, datë 26.4.2017, “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, 2017–2020”, është hartuar ky urdhër, për zbatimin e të cilit ngarkohet Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. Pjesëmarrja në aktivitetet, proceset konsultuese dhe vendimmarrëse, që lidhen me fëmijët dhe për fëmijët, është një nga parimet bazë të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve, i cili artikullohet me anë të nenit 12, që përcakton qartazi se fëmijët gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse që ndikojnë jetën e tyre. Po kështu, Neni 23, në mënyrë specifike ju jep fëmijëve me aftësi të kufizuara të drejtën për pjesëmarrje në komunitet ndërsa neni 2 sanksionon zbatimin e gjithëçfarë parashtrrohet në Konventë për çdo fëmijë.

Në vitin 2017, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, neni 12 i këtij ligji sanksionon lirinë e shprehjes së fëmijës. Neni 13 i ligjit 18/2017 garanton të drejtën e fëmijës për t’u dëgjuar vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit, jo vetëm në të gjitha proceset administrative e gjyqësore që lidhen me të, por edhe nga autoritetet shtetërore gjatë proceseve vendimmarrëse, që lidhen me hartimin e zbatimit e politikave për të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

Në paragrafin mbi parimet etike, garantimi i një qasjeje

gjithëpërfshirëse, përcaktohet në pikën 8 si një nga parimet, i cili kërkon që metodat e përdorura gjatë organizimit të proceseve me pjesëmarrje, të maksimizojnë shanset që vajzat dhe djemtë të marrin pjesë njëllor dhe në mënyrë të barabartë, që të bëhen të gjitha përpjekjet e të merren të gjitha masat që fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijë nga minoritetet apo nga grupet e pafavorizuara të përfshihen, gjithashtu, në mënyrë aktive dhe të plotë. Respektimi i së drejtës për pjesëmarrje të individëve apo të grupeve shoqërore të caktuara duhet, sidoqoftë, shoqëruar me vlerësimin e potencialit të rreziqeve që mund t’u shkaktohen si rezultat i angazhimit.

Ndërsa në paragrafin, mbi kriteret e përgjithshme specifikohet si një prej tyre, që pjesëmarrja e fëmijëve duhet të jetë gjithëpërfshirëse. Ndërkohë çështja e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara, shprehet edhe gjatë përshkrimit më të detajuar të kriterëve të tjera. Kështu, në përshkrimin e kriterit #4, për pjesëmarrjen e sigurt, specifikohet që vendet, sallat ku zhvillohen mbledhjet dhe aktivitetet me fëmijë janë vende ku fëmijët ndihen të qetë, të sigurt dhe të mbrojtur. Ata duhet të jenë të përdorshme edhe nga fëmijët me aftësi të kufizuara.

Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara specifikohet edhe në listën kontrolluese për mbarëvajtjen e procesit, apo në kapitullin mbi lehtësimin e procesit, duke nënvizuar përdorimin e metodave specifike në rastin e angazhimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Lexoni të plotë në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/06/09/367/a92d322b-694a-42af-a432-3d18d160c383>

VENDIM - Nr. 301, datë 15.4.2020

PËR NORMAT E STREHIMIT, SI DHE KUSHTET E STANDARDET PËR BANESAT SOCIALE ME QIRA QË BLIHEN NË TREG DHE BANESAT ME KOSTO TË ULËT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 13, të pikës 3, të nenit 21, të pikës 3, të nenit 45, dhe të pikës 3, të nenit 48, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, është aprovuar ky vendim, i cili ka për qëllim të përcaktojë: a) normën e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit; b) kushtet dhe standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg; c) standardet e banesave me kosto të ulët.

Ky vendim mes të tjerash parashikon se në rastet kur në përbërje të familjes ka një a më shumë persona me aftësi të kufizuara, norma e strehimit për personin e parë është 40m². Për çdo

person shtesë, sipërfaqja neto shtohet me 10m² dhe llogaritet sipas formulës:

$$\text{Sipërfaqja Neto e Banesës} = 30\text{m}^2 + N \times 10\text{m}^2$$

Ndërkohë, VKM përcakton se banesat sociale ndërtohen, blihen nga tregu apo përshtaten në zona të cilat plotësojnë disa kushte, përfshirë pajisjen me ashensorë të përshtatshëm për akses nga persona me aftësi të kufizuara, në masën një ashensor për jo më shumë se 75 njësi banimi.

Lexoni të plotë në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/04/15/301/37da68ed-a131-4a4b-bfe8-dabbea66302d>

VENDIM - Nr. 353, datë 29.4.2020

PËRDISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 327, DATË 28.5.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT DHE MËNYRËSSË MBLEDHJES E TË RAPORTIMIT TË TË DHËNAVE NGA OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, PUBLIK OSE PRIVAT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 3, të nenit 30, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 3, të nenit 59, të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave, është aprovuar ky vendim i cili shfuqizon pikën 9 të vendimit nr. 327, datë 28.5.2014, dhe shton pas pikës 1 të

këtij vendimi, pikën 1/1, me këtë përmbajtje: “1/1. Ofruesit e shërbimit të kujdesit shëndetësor, publik ose privat, raportojnë të dhëna në sistemin e informacionit shëndetësor, sipas përcaktimeve në vendimin nr. 135, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e nomenklaturës së klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve, ICD-10”.

Lexoni të plotë në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/04/29/353/8ce87f30-4953-4c1f-9f72-7f81ac7a12ba>

VENDIM - Nr. 371, datë 6.5.2020

PËR DHËNIE SHPËRBLIMI PËR PERSONELIN QË SHËRBEN NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESJES SHOQËRORE REZIDENCIALE PUBLIKE, QË JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR DHE TË BASHKIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u aprovua ky vendim i cili parashikon dhënien e një shpërblimi në masën 55 000 (pesëdhjetë e pesë mijë) lekë, për personelin që shërben në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike, që janë në përgjegjësi administrimi të Shërbimit Social Shtetëror dhe të bashkive, të angazhuar në shërbimin ndaj përfutuesve të

sistemuar në këto institucione deri në përfundim të epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19. Shpërblimin e përfiton personeli që shërben në institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, dhe që është caktuar nga drejtuesi i institucionit për të punuar përtej kushteve normale të punës, me qëllim parandalimin e infektimit nga COVID-19 të përfutuesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike, sipas një grafiku të dakordësuar ndërmjet tyre.

Lexoni të plotë në: <https://qzb.gov.al/eli/vendim/2020/05/06/371/05b9edad-bdf8-4a3b-bb5f-fb9459508bba>

URDHËR - Nr. 254, datë 10.4.2020

PËR PROTOKOLLIN E FUNKSIONIMIT TË QENDRAVE REZIDENCIALE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE, QË OFROJNË SHËRBIMIN E STREHIMIT (STREHËZAT) PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE DHE TRAFIKIMIT, NË SITUATËN E PANDEMISË SË COVID-19

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e përkujdesit shoqëror në RSH”, dhe të VKM-së nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, MSHMS miratoi këtë urdhër i cili ngarkon Shërbimin Social Shtetëror, strehëzat për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, bashkitë për zbatimin e tij.

Duke qenë se eksperiencia botërore paraqet fakte të mundësisë së rritjes apo përshkallëzimit të dhunës në familje në kushte të

distancimit social dhe izolimit të detyruar, si dhe nisur nga disa raste të incidenteve të dhunës në familje të ndodhura gjatë muajit mars 2020 në situatën e emergjencës së COVID-19, përgatitja e protokollit për funksionimin e qendrave rezidenciale publike dhe jopublike, që ofrojnë shërbimin e strehimit (strehëzat) për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, në situatën e pandemisë së COVID-19”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri, mori përparësinë e duhur.

“Protokolli i emergjencës COVID-19 për strehëzat” është i vlefshëm vetëm në kushtet e emergjencës së COVID-19 (por mund të përdoret si referencë në kushte të emergjencave të ngjashme të sëmundjeve infektive e pandemive, duke përditësuar pjesë të caktuara të tij në varësi të llojit të sëmundjes dhe masave ▶▶

perkatëse që do ndërmerren nga shteti për përballimin e saj). Ai nuk shfuqizon standardet dhe procedurat e funksionimit të qendrave rezidenciale publike e jopublike që ofrojnë shërbime të specializuara të strehimit për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, zbatimi i të cilave mbetet i detyrueshëm në situatë joemergjence.

Në urdhër vihet në dukje fakti se shqetësim më të madh përbëjnë grupe të caktuara të grave si: gratë me aftësi të kufizuara, gratë emigrante apo azilkërkuese të pa pajisura me dokumente dhe gratë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore. Studimet e deritanishme, bazuar dhe në eksperiencat nga përballja me pandemi të mëparshme, tregojnë se grupet më të rrezikuara në këtë situatë të pandemisë së COVID-19 janë ata që për të

siguruar jetesën varen shumë nga ekonomia informale, si dhe që kanë qasje të kufizuara në shërbime sociale apo në teknologji.

Kështu, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, personat e infektuar apo që jetojnë me virusin HIV, personat me statusin e refugjatit, migrantit apo azilkërkuesit, të moshuarit, personat që aktualisht jetojnë në kushtet e një dëmtimi të mëparshëm të një situatë të emergjencës civile, personat nën mjekim të vazhdueshëm, minoritetet etnike apo personat LGBTI, renditen ndër më të cenuarit në këtë situatë.

Lexoni të plotë në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/04/10/254/ee688490-ab32-4bf0-8e1e-cb31ba575392>

VENDIM - Nr. 348, datë 29.4.2020

PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË NXITJES NËPËRMJET VETËPUNËSIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", është miratuar vendimi për programin e nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit, i cili është i vlefshëm për cdo punëkërkues, përfshirë punëkërkuesit me aftësi të kufizuara.

Programi i vetëpunësimit është program njëvjeçar për mbështetjen e sipërmarrjeve të reja, nëpërmjet të cilit ofrohet trajnim për sipërmarrjen dhe zhvillimin e planeve të biznesit për aplikuesit dhe grant për përfituesit. Fondi i nxitjes së punësimit për programin

sipas pikës 1, të këtij kreu, mbulon shpenzimet për: a) grantin për hapjen e biznesit të ri; b) vlerësimin e planeve të biznesit. Për të aplikuar në këtë program, aplikuesi duhet të plotësojë kriteret: a) Është punëkërkues i papunë i regjistruar në strukturën vendore të punësimit; b) Ka një ide biznesi. Programi subvencionon për të gjithë të përzgjedhurit si përfitues grantin për ngritjen e biznesit deri në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

Lexoni të plotë në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/04/29/348/3c802c3b-9aa0-44c4-b3f3-ff5cf7fca705>

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).
Përmbajtja e paraqitur nuk përfaqëson qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).



Norwegian Embassy

